



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. 230/4 Prot

Tiranë, më 02/3/2020

VENDIM

Nr. 08, datë 02 . 3 .2020

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Organizata “Qëndresa Qytetare”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 230 Prot., datë 10.02.2020, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1”(në vijim quajtur “Autoriteti Publik”).

Ankuesi në cilësinë e kërkuesit, nëpërmjet kërkesës së datës 27.01.2020, ka kërkuar t’i vihet në dispozicion dokumentacioni në lidhje me:

1. *Kopje e të gjitha kontratave të nënshkruara dhe lidhura me të tretë gjatë vitit 2019 për riparimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e godinave të Rezidencës Studentore Universitare Nr.1.*
2. *Kopje të buxhetit për vitin 2019 duke përfshirë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve.*
3. *Kopje të kontratës së qirasë nr. 1522 prot., datë 07.12.2017 me Tirana Parking.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën me objekt refuzimin e dhënies së informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa është në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014, “Për të drejtën e informimit” dhe ankuesi legjitimohet në kërkimin e tij.

Në këtë kuadër, pas vlerësimit të ligjshmërisë së ankimit, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr. 37, datë 18.02.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik, me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Pas depozitimit të urdhrin dhe regjistrimit pranë autoritetit publik me nr. 177 Prot., datë 20.02.2020, grupi i inspektimit kontaktoi me titullarin e Autoritetit Publik, e cila deklaroi ndër të tjerat se: “...nëpërmjet shkresës Nr. 179 prot., datë 20.02.2020, dokumentacioni i kërkuar i është përcjellë Bashkisë Tiranë, në cilësinë e organit qendror”.

Nga inspektimi rezultoi se Autoriteti Publik e disponon informacionin e kërkuar. Në përfundim të procedurës së inspektimit, u hartua procesverbali i cili u nënshkrua pa vërejtje nga ana e titullarit të Autoritetit Publik.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, në zbatim të nenit 24/3 të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” në të cilin citohet se “Me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve”, me shkresën nr. 230/3 prot., datë 25.02.2020, Komisioneri ftoi palët në seancë dëgjimore, e cila u zhvillua me praninë e ankuesit dhe përfaqësuesit të Autoritetit Publik.

Gjatë seancës, pala ankuese dhe përfaqësuesi i Autoritetit Publik rikonfirmuan qëndrimet e tyre të reflektuara në aktet shkresore të trajtuara më sipër.

Pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar, Komisioneri vlerëson se, argumenti i parashtruar nga Autoriteti Publik për mos vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nuk qëndron.

Në nenin 1 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, përcaktohet se objekt i këtij ligji është çdo informacion që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. Në këtë kuptim, çdo autoritet që disponon informacionin e kërkuar, detyrohet të garantojë njohjen e publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë. Përderisa autoriteti deklaron se disponon informacionin e kërkuar, duhet ta vërë atë në dispozicion të kërkuesit.

Gjithashtu, në lidhje me dokumentin e kërkuar në pikën 2 të kërkesës, bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ky dokument përfshihet në kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë. Për rrjedhojë, bazuar në shkronjën e) të dispozitës së sipërcituar, në përputhje me programin e transparencës së miratuar për çdo autoritet publik, këto të fundit përgatitin në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, si dhe vënë në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet “të dhëna

për buxhetin dhe planin e shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe vitet e kaluara, si dhe çdo raport vjetor për zbatimin e buxhetit. Në ato raste kur autoriteti publik vetëfinancohet nga tarifatat e licencave ose çdo formë tjetër e financimit të drejtpërdrejtë nga subjektet e rregulluara prej tij, bëhen publike edhe dokumentet që tregojnë gjendjen e shlyerjes së detyrimeve nga subjektet e licencuara". Kjo dispozitë evidenton qartë detyrimin, jo vetëm për të dhënë dokumentin e kërkuar, por për të publikuar atë në faqen zyrtare të autoritetit në kuadër të transparencës.

Sa më sipër, nga hetimi administrativ rezulton se informacioni i kërkuar nga Organizata "Qëndresa Qytetare", disponohet nga autoriteti publik duke përbushur në këtë mënyrë kërkesat e pikës 2 të nenit 2 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" sipas të cilit "informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik".

Autoriteti Publik, gjatë vënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, duhet të mbajë në konsideratë parashikimin sipas pikës 6 të nenit 17 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ku përcaktohet se: "Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim".

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit".

E drejta për informim është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Organizatës "Qëndresa Qytetare" ndaj Rezidencës Studentore Universitare Nr.1, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 230 Prot., datë 17.01.2020 të Organizatës "Qëndresa Qytetare", përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik

“Rezidenca Studentore Universitare Nr.1”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.

2. Urdhërimin e Autoritetit Publik për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar në lidhje me:
 1. Kopje e të gjitha kontratave të nënshkruara dhe lidhura me të tretë gjatë vitit 2019 për riparimin, rindërtimin dhe rikonstruksionin e godinave të Rezidencës Studentore Universitare Nr.1.
 2. Kopje të buxhetit për vitin 2019 duke përfshirë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve.
 3. Kopje të kontratës së qerasë nr. 1522 prot., datë 07.12.2017 me Tirana Parking, brenda datës 09. 3 .2020.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02. 3 .2020.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

